



**ZYRA E KRYETARIT TË KOMUNËS
KËSHILLI KOMUNAL PËR SIGURI NË BASHKËSI**

Nr.Prot.	01/2024
Për:	Kryesuesin e Kuvendit të Komunës së Suharekës- z. Bexhet KUÇI
Nga:	Kryetari i Komunës në Suharekë njëherit Kryesues i KKSB-së
Lënda:	Informatë për aktivitet e KKSB-së për periudhën Janar-Qershor 2024
Datë:	03.07.2024

Nga takimet e Këshillit Komunal për Sigurinë e Bashkësive “KKSB” në Komunën e Suharekës, të paraparë sipas Udhëzimit Administrativ të nënshkruar nga Ministria e Punëve të Brendshme dhe Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal 27/2012, MPB dhe 03/2012, MAPL për themelimin e Këshillave Komunale për Siguri në Bashkësi KKSB, ju dërgojmë këtë:

I N F O R M A T Ë

Pas konstituimit të organeve të Komunës në Suharekë, të daluar nga zgjedhjet lokale të vitit 2021, Kuvendi i Komunës në muajin janar të vitit 2022, ka themeluar Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB-në), konform Ligjeve dhe akteve tjera nënligjore të aplikueshme në Republikën e Kosovës, si organ këshillues për çështjet e sigurisë në bashkësi me përfaqësim të gjerë të të gjitha komuniteteve dhe përfaqësues të shoqërisë civile.

Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB-ja) për periudhën Janar-Qershor të vitit 2024, ka mbajtur tri (3) takime të rregullta dhe ato konform planit të veprimit të miratuar nga Kuvendi i Komunës së Suharekës.

Në këto takime kanë marrë pjesë kryesisht shumica e anëtarëve të KKSB-së.

Në takimin e parë (1) të rregullt, të mbajtur me datën 13.02.2024, tema diskutimi kanë qenë:

- **Analizimi i vjedhjeve në territorin e Komunës së Suharekës;**
- **Identifikimi dhe krijimi i zonave të gjelbëruara përreth shkollave për të ruajtur hapësirën dhe sigurinë e plotë të nxënësve;**
- **Informatë dhe diskutim për projektet të infrastrukturës dhe të shërbimeve që ndikojnë në sigurinë e qytetarëve;**
- **Trajtimi i qenve endacak;**

Sa i përket analizimit të vjedhjeve numri i vjedhjeve është i njëjtë sikur vitin e kaluar. Në dhjetor kanë qenë 5 vjedhje, në janar 10 vjedhje dhe në shkurt deri tani i kemi 2 vjedhje. Prej 17 vjedhjeve policia deri tani i ka zbuluar 6 raste ndërsa tjerat janë në procedurë.

Kjo pikë e rendit të ditës po përsëritet nga viti në vit dhe kjo me qëllim që të marrim projekte nga anëtarët e KKSB-së, nga OJQ-të por pse jo edhe nga shoqëria civile, për hapësirat e gjelbëruara përreth shkollave. Komuna ka punuar shumë rreth krijimit të ambienteve të mira dhe të gjelbëruara nëpër shkolla dhe për rreth shkollave.

Problemi i qenve endacak është problem madhor në gjithë Kosovën. Ne si komunë vazhdimisht kemi bërë përpjekje për të bërë zgjidhje optimale apo të qëndrueshme por është

një problem i cili është vështirë për tu zgjidhur. E kemi një procedurë tenderuese ku çdo vit planifikojmë buxhet për trajtimin e këtyre qenve endacak ato procedura të cilat janë parapa me ligj në bazë të rregulloreve dhe rregullave të agjencionit të ushqimit dhe veterinisë.

Konkluzion apo rekomandim nga ky takim ka dalë:

- *Si çdo herë të vazhdojë bashkëpunimi mes policisë dhe komunitetit dhe institucioneve tjera përgjegjëse.*
- *Projektet që dorëzohen nga anëtarët e KKSBB-së e që ndërlihen me çështjen e sigurisë, komuna ti merr parasysb dhe ti realizoj.*
- *Drejtoria e Inspeksionit në bashkëpunim me policinë ti lirojnë hapësirat publike për lëvizjen e lirë të qytetarëve për shkak të investimeve që po bëhen në qytet.*

Në takimin e dytë (2) të rregullt të mbajtur me datën 16.04.2024, tema diskutimi kanë qenë:

- **Vlerësimi i përgjithshëm i sigurisë në territorin e Komunës;**
- **Vetëdijesimi i nxënësve për rrezikun nga minat dhe mjeteve të tjera të pa shpërthyer nga lufta;**
- **Mbështetja e projekteve konkrete në zgjidhjen e problemeve të sigurisë në bashkësi dhe komunitetit;**
- **Masat për parandalimin e lëmshë-kërkuesve;**

Sa i përket situatës së sigurisë në komunën e Suharekës është një situatë e qetë dhe stabile bazuar në raportin tremujor. Sa i përket incidenteve kemi 16 incidente më pak se tremujorin e kaluar. Sa i përket sigurisë në trafik nuk kemi asnjë rast me aksident me fatalitet, kemi rënie të aksidenteve me lëndime dhe kemi më pak aksidente me dëme materiale. Sa i përket raportimit gjatë tremujorit të parë nuk kemi pas asnjë vrasje të raportuar, nuk kemi pas asnjë grabitje si raste më kapitale. Vepra penale të kanosjeve nga 11 raste, tani kemi 9 raste apo 18 % më pak; vjedhje nga 14 raste që kemi pas, tani kemi 9 apo -35%; vjedhje të rënda të shtëpive nga 12 raste, tani kemi 18 raste; raste të dhunës në familje nga 18 raste tani kemi 13 raste ose -27%; aksident me lëndime të rënda nga 2 raste, tani kemi 1 rast; aksidente me dëme material nga 52, tani kemi 51 raste; urdhëresa të realizuara nga 216, tani kemi 164 urdhëresa të gjykatës; tiketa në trafik nga 2976, tani kemi shqiptuar 3055. Policia e Kosovës ka mbajtur ligjërata nëpër shkolla me temën dhuna në familjet sipas rekomandimit të DKA-së.

Në kuadër të planit të punës së KKSBB, nga FSK-ja ka qenë kërkesë që të jetë kjo pikë e rendit të ditës që të mbajnë ligjërata për çështjen e vetëdijesimit të nxënësve për mjetet e pa shpërthyer pas luftës në Kosovë dhe në kuadër të KKSBB-së e kemi trajtuar këtë çështje.

Kohëve të fundit janë duke u paraqitur disa raste të lëmshë kërkuesve, mirëpo sipas raporteve të policisë këta lëmshë kërkues janë nga vendet e ndryshëm të Kosovës dhe nga Shqipëria.

Konkluzion apo rekomandim nga ky takim ka dalë:

- *Edhe më tutje le të vazhdojë bashkëpunimi në mes përfaqësuesve të komiteteve dhe policisë dhe çdo rast që vlerëson dhe konsideron qytetari që është e rreziqshme ta paraqesin në polici.*
- *Drejtoria e arsimit të bëjë kërkesë në Ministrinë e Mbrojtjes për trajnimin dhe mbajtjen e ligjëratave për nxënës dhe qytetarë, që ta mbaj një aktivitet lidhur me mjetet e pa shpërthyer aty ku drejtoria e arsimit e shef të nevojshëm dhe të arsyeshme.*
- *Të bëjnë kontroll të vazhdueshme në qytetin e Suharekës dhe për rreth në bashkëpunim me Inspeksionin me qëllim të zhbllokimit të trotuareve nga parkimet e automjeteve në vendet e pa lejuar për parking si dhe nga gjësendet e ndryshme.*
- *Policia të marrin masa të vazhdueshme për lëmshë-kërkuesit dhe në veqanti për shtetasit e Republikës së Shqipërisë.*

Në takimin e tretë (3) të rregullt të mbajtur me datën 18.06.2024, tema diskutimi kanë qenë:

- Diskutim për aktivitetet e organizuara nga Drejtoria e Arsimit për maturantët;
- Prishja e rendit dhe qetësisë publike nga lokalet e natës dhe personat e pa përgjegjshëm;
- Parapërgatitja dhe vetëdijesimi i qytetarëve për mbrojtje nga zjarri gjatë sezonit veror;

Sipas të dhënave nga Drejtoria e Arsimit, sa i përket aktiviteteve që janë organizua për maturantët e Komunës së Suharekës, çdo gjë ka shkuar në rregull. Këtë vit paraqitja e testi të maturës ka qenë online i cili ka paraqit disa vështirësi dhe 97% e maturantëve e kanë paraqit me sukses provimin dhe ne si drejtori e Arsimit po merremi që edhe këta nxënës që kanë mbet me përfunduar këtë procedurë. Ekskursionet kanë përfunduar sipas planifikimit dhe pa vërejtje. Gjithë ashtu shkollat kanë organizua mbrëmjet e maturës dhe mbrëmjet kanë shkuar sipas rregullave dhe pa asnjë incident. Janë rreth 497 maturantë që pritet me 22.06.2024 t'i nënshtrohen testit të maturës dhe shpresoj që do të kemi sukses. Besoj që ky proces do të rrjedh normalisht sepse janë disa vite që ky proces po zhvillohet pa asnjë incident. Po ashtu maturantët e kanë kryer ekskursionin në Shqipëri dhe sipas informatave, profesorët kanë shpreh admirimin më të mirë për sjelljen dhe disiplinën për këta fëmijë.

Sa i përket prishjes së rendit dhe qetësisë publike nga lokalet e natës dhe personat e pa përgjegjshëm situatën në përgjithësi e kemi të qetë me përjashtim të ndonjë rasti i cili pas njoftimit që bëhet nga qytetaret policia e Kosovës me njëherë këto raste i ndalon me qellim që te ju krijohet kushte për jetës dhe siguri qytetareve.

Jemi në prag të fushatës së korrjeshirjeve që gjithë ashtu do të jemi vigjilent ne si drejtori bashkë me shërbimet zjarrfikëseve që fatkeqësisht numri është i vogël por ne do të bëjmë përpjekje që të bëjmë disa njësi vullnetare së paku nëse mund të organizohemi nëpër fshatra. Ne zakonisht e bëjmë një thirrje publike nëpërmjet zyrës së Kryetarit, thirrje për apel për kujdes dhe ngritjen e vigjilencës që të gjithë të jenë të gatshëm në parandalimin e zjarrit. Këto njoftime i bëjmë edhe përmes Radio Valës. Do të bëjmë dhe një kërkesë shtesë në Ministrin përkatëse për rritjen e numrit të zjarrfikëseve nëse ata pranojnë.

Konkluzione apo rekomandime nga ky takim ka dalë:

- Të rritet bashkëpunimi me qytetarët dhe policinë;
- Policia së bashku me inspektoratin ta ngrisin vigjilencën gjatë periudhës sa janë mërgimtarët por jo duke përjashtuar vazhdimin e ngritjes së vigjilencës së kontrollimit dhe mbajtjes nën kontroll të të gjitha lokaleve të cilët punojnë më tepër se sa është e përcaktuar me fillimin dhe mbarimin e orarit të punës.
- Të ngritet vigjilencia nga ana e policisë për ruajtjen e sigurisë dhe qetësisë për sezonin veror; Motoja të jetë publike "Festo me zemër dhe jo me armë" gjatë abengjeve familjare;
- Konkluzion tjetër apo rekomandim nga ky takim ka qenë që të shtohet numri i zjarrfikëseve gjatë sezonit të verës, të merren masa preventive për mos djegjen e fushave, të njoftohen me shkrim pishinat për raste emergjente për furnizim me ujë nga pishinat dhe në raste emergjente të bashkëpunohet me FSK;

Me respekt!

Kryetari i Komunës

Bali MUHARREMAJ